



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

viti shkollor 2010/2011.

TESTI 1

MATEMATIKË

UDHËZIM PËR PUNË NË TEST

Testi të cilin duhet ta plotësosh i ka 20 detyra. Për zgjidhjen e këtij testi janë parashikuar 120 minuta. Secilën detyrë së pari lexoje me kujdes mendo për këtë se çfarë kërkohet në të. Së pari zgjidhi ato detyra të cilat janë më të lehta për ty, e më vonë zgjidhi ato detyra të cilat për ty janë të vështira.

Lexoje me kujdes tekstin e secilës detyre sepse në të është shpjeguar në çfarë mënyre duhet të përgjigjesh. Në detyra prej teje kërkohet të rrethosh shkronjën para përgjigjes së saktë, t'i bashkosh pjesët e përgjigjesh, të shkruash diçka etj.

Ki kujdes për mënyrën se si duhet të përgjigjesh. Gjatë punës mund të përdorësh gomën, vizoren, trekëndëshin dhe kompasin. Nuk guxon ta përdorësh telefonin/celularin dhe kalkulatorin (digitronin).

Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shëno asgjë, ajo është hapësirë në të cilën shënohet numri i pikave.

Në këtë dhe në faqen e fundit mos shkruaj asgjë.

Testin duhet ta plotësosh me **stilolaps**. Gjatë punës mund të përdorësh lapsin grafit dhe gomën. Detyrat zgjidhi së pari me laps grafit sepse kështu ke mundësi që, nëse e vëren gabimin, këtë gabim ta korrigjosh.

Para se që e dorëzon testin, verifiko përgjigjet tuaja edhe njëherë, e pastaj të gjitha përgjigjet shkruaj me stilolaps. Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps grafit nuk do të pranohet, por as përgjigjja të cilës i është hequr vizë. Nëse e vëren se dikund ke gabuar asaj detyre hiqi vizë, dhe shkruaje qartë cila përgjigje mendon se është mirë.

Nëse e mbaron testin më herët, dorëzoja testin arsimtarit kujdestar dhe dil ngadalë që të mos i pengosh shokët.

Të dëshirojmë sukses në provim!

1. Për secilin pohim rretho I SAKTË, e nëse mosbarazimi është i saktë, ose I PASAKTË nëse mosbarazimi nuk është i saktë.

$$\frac{1}{2} < \frac{2}{3}$$

I SAKTË

I PASAKTË

$$\frac{2}{3} > 1$$

I SAKTË

I PASAKTË

$$\frac{11}{5} < 2$$

I SAKTË

I PASAKTË

$$-4 < -2$$

I SAKTË

I PASAKTË



2. Bashko secilën shprehje me vlerën përkatëse.

$$\frac{3}{7} + \frac{2}{7} \bullet$$

$$\bullet \frac{6}{7}$$

$$\frac{5}{9} - \frac{3}{9} \bullet$$

$$\bullet \frac{3}{7}$$

$$6 \cdot \frac{1}{7} \bullet$$

$$\bullet \frac{5}{7}$$

$$\frac{6}{7} : 2 \bullet$$

$$\bullet \frac{2}{9}$$



3. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Shprehjes x^5 i përgjigjet shprehja:

- a) $x + x + x + x + x$
- b) $x + 5$
- c) $x^2 + x^3$
- d) $x \cdot x \cdot x \cdot x \cdot x$

4. Është dhënë funksioni $y = 10x - 5$.

Plotëso tabelën me vlerat përkatëse për x dhe y .

x	0	$\frac{1}{2}$		5
y			5	

5. Sa është sipërfaqja e rrethit të rrezes 9 cm?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 18 cm^2
- b) $18\pi \text{ cm}^2$
- c) 81 cm^2
- d) $81\pi \text{ cm}^2$


6. Pishina është e gjatë 12 m, e gjerë 5 m, e thellë 2 m. Sa metra kub të ujit më së shumti mund të ketë në atë pishinë?

Në pishinë mund të ketë më së shumti _____ metra kub të ujit.

7. Kaltrina saktësisht e ka matur këndin α në fotografi. Si duhet ta shkruajë Kaltrina rezultatin e matjes së vet?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 110 cm
- b) 110'
- c) 110°
- d) 110 mm
- e) 110''




8. Dritani është i gjatë 147 cm. Katër shokë në kontroll sistematik e kanë matur gjatësinë e tij. Vetoni e ka matur 1 m e 50 cm, Arti e ka matur 1 m e 45 cm, Roni e ka matur 1 m e 40 cm dhe Rigoni 1 m e 55 cm. Cili shok e ka bërë gabimin më të vogël gjatë matjes.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.


- a) Vetoni
- b) Arti
- c) Roni
- d) Rigoni

9. Në grafikon është dhënë të vizituarit e një web faqeje të internetit në mijëra. Në cilin muaj më së shumti, e në cilin më së paku e kanë vizituar vizitorët atë faqe?



Web faqen më së shumti e kanë vizituar në _____, kurse më së paku në _____.

10. Një grup i të të anketuarëve është përgjigjur në pyetjen sesi secili prej tyre e kalon kohën e lirë. Në bazë të grafikonit i cili i pasqyron përgjigjet e tyre plotëso tabelën përkatëse.



Aktiviteti	Numri i të të anketuarëve
Të lexuarit	
Interneti	
Filmat	
Sporti	
Aktivitetet tjera	

- 11.** Në 200 g të përzierjes së çajit $\frac{2}{5}$ është mendër, $\frac{1}{8}$ është balsam, kurse pjesa tjetër është çaj kamomileje. Sa gramë kamomileje janë në atë përzierje çaji?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 85 g
b) 95 g
c) 105 g
d) 115 g



- 12.** Janë dhënë binomet $M = -6m + n$ dhe $N = m - 4n$. Thjeshtëso shprehjen.

a) $M + N =$


b) $M - N =$

c) $M \cdot N =$



- 13.** Sa është këndi i jashtëm γ_1 i cili i përgjigjet kulmit C të katërkëndëshit $ABCD$ në fotografi?
Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.


- a) 56°
b) 66°
c) 76°
d) 86°



- 14.** Naimi shkon në ekskursion në Vjenë. Rruga dhe qëndrimi i kushtojnë 360 euro dhe i paguan në gjashtë këste të barabarta. Çfarë shume duhet të paguajë Naimi në dinarë për këstin e parë, nëse në ditën e pagimit një euro e ka pasur vlerën 103 dinarë?

Naimi për këstin e parë duhet të paguajë _____ dinarë.

- 15.** Në bazë të koordinatave të dhëna të pikës A vizato në sistemin koordinues pikën $M(1, 2)$.



- 16.** Për sa është vëllimi i prizmit të rregullt gjashtëkëndësh tehet bazë të të cilit janë 6 cm dhe lartësia 4 cm më e madhe nga vëllimi i piramidës së rregullt gjashtëkëndëshe tehet bazë të së cilës janë 6 cm dhe lartësia e piramidës 4 cm?
Tregoje procedurën.

Vëllimi i prizmit është më i madh për _____ cm^3 .

- 17.** Klubi i futbollit “Feniks” e lejon zbritjen prej 18% për blerjen e biletave një javë para ndeshjes. Nëse çmimi i biletës pa zbritje është 350 dinarë sa kushton bileta me zbritje. Tregoje procedurën.

Çmimi i biletës me zbritje është _____ dinarë.

- 18.** Llogarite vlerën e shprehjes.

$$\left(\left(1 + \frac{1}{2} \right) : (-1 - 0,5) \right) \cdot \left(\left(\frac{1}{4} - \frac{5}{2} \right) : \left(3 \cdot \left(4 \cdot \frac{1}{4} + \frac{5}{3} \right) \right) \right)$$

Tregoje procedurën.

Vlera e shprehjes është _____.

- 19.** Për cilat vlera të ndryshores x është shuma e shprehjes $\frac{2x+3}{6}$ и $\frac{5-3x}{7}$ më e madhe se -7 ?
Tregoje procedurën.

Përgjigja: _____



- 20.** Sadia ka dashur të blejë truallin për rritjen e ushqimit organik. Ka marrë ofertat për tri troje. Trualli i parë e ka sipërfaqen $0,004 \text{ km}^2$ dhe çmimi i këtij trualli është 1 968 000 dinarë. Trualli tjetër e ka sipërfaqen 0,32 ha dhe çmimi i këtij trualli është 1 619 200 dinarë. Trualli i tretë e ka sipërfaqen 45 a dhe çmimi i këtij trualli është 2 196 000 dinarë.

Sa është çmimi më i ulët për një metër katror nga trojet e ofruara?

Tregoje procedurën.

Çmimi më i ulët për një metër katror është _____ dinarë.



Rezultati në testin e matematikë

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!
Këtë faqe e plotëson Komisioni!

Numri i përgjithshëm i pikave

		,	
--	--	---	--

Numri i pikave për secilën detyrë.

Numri i detyrës	E paplotësuar	0 pika	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Komisioni:

- _____
- _____
- _____
- _____

Shkruaj ✕ në vendin përkatës.

Numri i identifikimit (Shifra e nxënësit)	
Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	